

MONITORI I TË DREJTAVE PRONËSORE

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) punon me institucionet e Kosovës për të mbështetur zbatimin e politikës dhe kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe banesore të anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe personave të zhvendosur (PZH). Për të ndihmuar në këto angazhime, OSBE rregullisht monitoron dhe raporton mbi zhvillimet, dhe këshillon institucionet në respektimin e legjislacionit përkatës, standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira. Monitori i të drejtave pronësore është publikim gjashtëmujor i vëzhgimeve të monitoruesve të OSBE-së në terren në pesë rajonet vijuese: Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR); dhe Prizren (PZ). Ky publikim synon të ofrojë një përmbledhje të situatës në terren mbi të drejtat pronësore dhe banesore të anëtarëve të komunitetit jo-shumicë dhe PZH-ve. Publikimi shërben për ti ndihmuar institucionet përgjegjëse në adresimin e çështjeve shqetësuese përkritazi me zbatimin e legjislacionit dhe vendimeve, si mekanizëm për të ndjekur progresin e arritur dhe për të mbyllur mangësitë e identifikuara. Informacioni i paraqitur më poshtë ofrohet ashtu siç është mbledhur nga ekipet e terrenit të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe rrjedhimisht mbulon vetëm rastet në të cilat ekipet e terrenit kanë pasur qasje gjatë periudhës kohore nga muaji gusht deri në fund të dhjetorit 2020.

BOTIMI 3: GUSHT 2020 - DHJETOR 2020

Temat

Shpronësimi paraqet një ndërhyrje nga autoritetet në pronën private dhe publike, duke hequr të drejtat e pronësisë, me qëllim të arritjes së një interesi të caktuar publik. Ai i nënshtrohet kushteve të përcaktuara me ligj, ku parashihet edhe kompensimi për pronarët e prekur. Ky botim i Monitorit paraqet numrin e ndërhyrjeve që prekin pronat e komuniteteve jo-shumicë dhe PZH-ve.

Uzurpimi i paligjshëm i pronës se paluajtshme është vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal. Pronat e komuniteteve jo-shumicë vazhdimisht kanë qenë objekt i okupimit të paligjshëm. Ky botim i Monitorit pasqyron numrin e uzurpimeve të paligjshme të pronave që kanë ndodhur në periudhën për të cilën raportohet.

Banimi social është një obligim i autoriteteve për të adresuar nevojat e banimit të individëve dhe familjeve që nuk mund t'i përballojnë vetë kushte e duhura të jetesës. Ky botim i Monitorit paraqet numrin e rasteve të grupeve të cënueshme, siç janë gratë dhe komunitetet joshumicë që kanë përfituar nga sigurimi i banesave sociale.

Trajtimi i ndërtimeve pa leje është proces që drejtohet nga autoritetet me qëllim të legalizimit të ndërtimeve pa leje. Ky botim përfshin numrin e rasteve të ndërtimeve që nuk kanë leje dhe janë të ndërtuara paligjshëm në pronat e anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë, e që i nënshtrohen legalizimit.

Planifikimi hapësinor është politika e autoriteteve për të rregulluar hapësirat publike në të gjitha nivelet. Pjesëmarrja në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor është jetike jo vetëm për vlerësimin dhe theksimin e nevojave të komuniteteve, por edhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave individuale pronësore. Ky botim pasqyron numrin e proceseve të planifikimit hapësinor ku është vërejtur pjesëmarrja e komuniteteve jo-shumicë.


Ndarja e tokës komunale për projekte që lidhen me kthimin është procedurë/iniciativë e autoriteteve që bëhet me qëllim të arritjes së interesit publik dhe/ose një politikë publike. Ky botim paraqet numrin e komunave që kanë ndarë tokë komunale për projektet e lidhura me kthimin dhe/ose për anëtarët e komuniteteve joshumicë brenda periudhës kohore për të cilën raportohet.

Tatimi i pronës së paluajtshme është pagesë e detyrueshme e paraparë dhe e zbatuar nga autoritetet për pronësinë e pronave banesore, bujqësore dhe komerciale. Megjithatë, ka raste kur pronat e anëtarëve të komuniteteve joshumicë janë uzurpuar/uzurpohen paligjshëm dhe si rezultat i kësaj pronarët vazhdojnë të bartin barrën e detyrimit tatimor pavarësisht faktit se nuk kanë posedim fizik të atyre pronave. Ky botim tregon numrin e anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë të liruar nga pagesa e tatimit në pronë të paluajtshme për pronat e uzurpuara paligjshëm.

RASTET LIDHUR ME TË DREJTAT PRONËSORE QË PREKIN KOMUNITETET JO-SHUMICË KUDO NË KOSOVË

SHPRONËSIMI	427
UZURPIMI I PALIGJSHËM	0
BANIMI SOCIAL	0
TRAJTIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE	5515
PLANIFIKIMI HAPËSINOR	6
NDARJA E TOKËS PËR PROJEKTET QË LIDHEN ME PZH-të	0
TATIMI NË PRONË TË PALUAJTSHME	0

RASTET E SHPRONËSIMEVE SIPAS RAJONIT




Shpronësimi

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, **300** parcela toke që u përkasin anëtarëve të komunitetit jo-shumicë dhe/ose PZH-ve u prekën nga procesi i shpronësimit. Në rajonin e Pejës u ndërmor shpronësimi për ndërtimin e segmentit Kijevë - Zahaq të autostradës Prishtinë – Pejë. Krahas kësaj, **120** parcela toke të komuniteteve jo-shumicë janë shpronësuar në komunën e Istogut për ndërtimin e segmentit rrugor Osojan – Rakosh. Për më tepër, në rajonin e Prishtinës, në komunën e Lipjanit, **7** prona të komuniteteve jo-shumicë u shpronësuan për ndërtimin e një unaze rrugore. Sidoqoftë, nuk u raportua asnjë ankesë nga pronarët e pronave në lidhje me rregullsinë e procesit ose kompensimin.

Uzurpimi i paligjshëm

Asnjë uzurpim i paligjshëm i pronave të komuniteteve jo-shumicë dhe/ose PZH-ve nuk është raportuar në këtë periudhë. Ky është një zhvillim i rëndësishëm që tregon mbrojtje të zgjeruar të të drejtave pronësore të komuniteteve të cënueshme në Kosovë.


RASTET E UZURPIMIT TË PALIGJSHËM SIPAS RAJONIT




Banimi social

Gjatë periudhës së raportimit, asnjë grua apo anëtarë të komunitetit jo-shumicë nuk përfituan nga skema e banimit social në Kosovë.

PRONAT E NDARA PËR BANIM SOCIAL SIPAS RAJONIT



RASTET E LEGALIZIMIT SIPAS RAJONIT




Legalizimi

Ligji i ri Nr. 06 / L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje hyri në fuqi më 5 Shtator 2018, dhe Udhëzimet Administrative në zbatim të Ligjit hynë në fuqi më 15 korrik 2019. Neni 10, paragrafi 2, i këtij ligji parashikon që një objekt i ndërtuar në ngastrën e tokës së një pale tjetër, nuk mund të legalizohet derisa të konstatohet pronësia ose e drejta për shfrytëzimin e ngastrës së tokës. Përmes këtij neni, Ligji synon të mbrojë grupet e cenueshme siç janë komunitetet jo-shumicë dhe/ose PZH-të, në raste të uzurpimit të paligjshëm të tokës së tyre.

Gjatë periudhës raportuese, janë parashtruar 5,515 kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje, në mbarë Kosovën, duke përfshirë edhe 27 kërkesa nga komunitetet jo-shumicë (18 serbë të Kosovës, 7 ashkali të Kosovës, 1 turk i Kosovës dhe 1 boshnjak i Kosovës). Numri i shtuar i kërkesave është për shkak të ndërgjegjësimit të rritur të banorëve për afatin e fundit për aplikim që është caktuar të jetë 4 shtatori 2021. Autoritetet komunale kanë lëshuar 1,887 vendime legalizimi, nga të cilat 12 për pronat që u përkasin komuniteteve jo-shumicë. Megjithatë, nuk është regjistruar asnjë rast i ndërtimeve të paligjshme mbi parcelat e tokave të uzurpuara të komuniteteve jo-shumicë dhe/ose PZH-ve.

Vlen përmendur: Shumica e komunave në Kosovës nuk mbajnë të dhëna të kategorizuara sipas komunitetit për kërkuesit në procesin e legalizimit.

PROCESET SIPAS RAJONIT



Planifikimi hapësinor

Gjatë periudhës raportuese, anëtarët e komuniteteve joshumicë kanë marrë pjesë në **6 procese të planifikimit hapësinor** – në rajonin e Pejës, Prizrenit dhe Prishtinës.


NDARJA E TOKËS PËR PROJEKTET QË LIDHEN ME PZH-TË SIPAS RAJONIT

	PR	MI	GN	PE	PZ
■ Numri i rasteve	0	0	0	0	0

Ndarja e tokës

Gjatë periudhës për të cilën raportohet **nuk ka pasur asnjë rast të ndarjes së tokës** komunale për projektet që lidhen me kthimin e PZH-ve.

TATIMI NË PRONËN E PALUAJTSHME



Tatimi në pronën e paluajtshme

Më 1 tetor 2018, hyri në fuqi Ligji Nr. 06 / L-005 për Tatimin e pronës së paluajtshme. Sipas nenit 39 të këtij ligji, personat, prona e të cilëve ka qenë, ose është uzurpuar në mënyrë të paligjshme, lirohen nga detyrimet tatimore bazuar në vendimin përfundimtar të lëshuar nga një autoritet publik kompetent në shqyrtimin e çështjeve të uzurpimit të paligjshëm.

Gjatë periudhës së raportimit, asnjë anëtar i komuniteteve jo-shumicë ose PZH nuk u lirua nga pagesa e Tatimit në pronën e paluajtshme. Krahasuar me periudhën korrik 2019 - korrik 2020, kur dy pronarë serbë të Kosovës u liruan nga pagesa e tatimit të pronës së paluajtshme në rajonin e Prizrenit.